

PROCES VERBAL

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

Tiranë, më 21.01.2021

Me datë 21.01.2021, ora 10.00, me kërkesën dhe nën drejtimin e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

1. Miratimi i strukturës, organikës dhe numrit të nëpunësve dhe punonjësve të Gjykatës së Lartë;
2. Miratimi i përshkrimit të përgjithshme të punës për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.
3. Shpallja e disa vendeve të lira në administratën e Gjykatës së Lartë.
4. Të ndryshme.

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

- | | |
|------------------|-------------------------------------------|
| 1. Sokol SADUSHI | Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë |
| 1. Ilir PANDA | Anëtar Gjykatës së Lartë |
| 2. Kelment GRECA | Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor |

Të pranishëm në mbledhje e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) z. A. V., me detyrë drejtor në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë
- 2) z. M. K., me detyrë këshilltar në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë;
- 3) z. A. G., me detyrë kancelar i Gjykatës së Lartë
- 4) zj. B. A., me detyrë sekretare gjyqësore, e ngarkuar për të mbajtur dhe zbardhur proces verbalin audio të mbledhjes.

Në fjalën hyrëse, Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës.

Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë i dha fjalën anëtarëve të Kabinetit të cilët kishin përgatitur një material lidhur me mënyrën e organizimit të njësive organizative të administratës së Gjykatës së Lartë, në të cilin ishin pasqyruar propozime për strukturën dhe organikën e Gjykatës së Lartë, referuar disa faktorëve esenciale, si ndryshimet ligjore të reja, akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, specifikës që ka dhe pozicionit që zë Gjykata e Lartë në arkitekturën gjyqësore, nevojat e Gjykatës së Lartë për të përmbushur funksionin e saj në drejtim të rritjes se

eficencës së stafit administrativ, menaxhimin me eficient e me cilësor të burimeve njerëzore e financiare, rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë si dhe mostejkalimin e limitit buxhetor të akorduar.

Për realizimin e këtyre objektivave, në material propozohet që struktura dhe organika e re të Gjykatës së Lartë të riorganizohet në rang drejtorie, dhe konkretisht Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, Qendra e Dokumentacionit, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, Drejtoria e IT-së dhe Sigurisë, dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore Financiare dhe Shërbimeve. Këto 5 drejtori, do të përbëhen nga dy sektorë, ku, bazuar në natyrën e punës dhe detyrave, si dhe me synim thjeshtimin e procesit vendimmarrës, në disa prej këtyre drejtorive, njëri prej sektorëve nuk do të ketë “përgjegjës sektori”, por mbarëvajtja e kontrolli i sektorit në drejtim të kryerjes së detyrave të përditshme do të bëhet direkt nga vetë Drejtori.

Mbas raportit, anëtarët e Këshillit të Gjykatës vijuan me diskutimet, duke paraqitur komente, sugjerime apo saktësime lidhur me emërtimin e Drejtorive që krijohen dhe organizimin e sektorëve brenda këtyre drejtorive, numrin e nëpunësve civilë gjyqësorë, efektet buxhetore që do të sillte kjo strukturë dhe organikë e re.

Në përfundim të diskutimeve dhe sqarimeve të bëra për çështjet e mësipërme, Këshilli i Gjykatës miratoi në mënyrë unanime strukturën organizative dhe numrin e nëpunësve dhe punonjësve të Gjykatës së Lartë.

Organika e Gjykatës së Lartë përbëhet në total nga 131 punonjës, ku përfshihen të gjitha strukturat qofshin ato me natyrë gjyqësore (Trupa Gjyqësore dhe Njësia e Shërbimit Ligjor) ashtu dhe ato me natyrë administrative (shërbimet gjyqësore, shërbimet administrative dhe shërbimet ndihmëse).

Pika e dytë e rendit të ditës ishte miratimi i përshkrimit të përgjithshëm të punës për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë. Mbase dëgjoi komentet e grupit të punës lidhur me nevojën e përshkrimit të punës të pozicioneve të reja të drejtorëve e drejtorive, Këshilli i Gjykatës miratoi përshkrimet e punës si dhe vendosi që të bëhet risistemimi i nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas strukturës dhe organikës së re të miratuar, nëpërmjet procedurës së transferimit.

Pika e tretë e rendit të ditës ishte shpallja e disa vendeve të lira në administratën e Gjykatës së Lartë. Këshilli në diskutimet e tij, nisur tashme nga fakti se struktura e re e Gjykatës është organizuar mbi bazë drejtorie, si dhe duke konsideruar zgjedhje më oportune për plotësimin e pozicioneve vakante, vlerësoi se është e nevojshme që të shpallen 4 vendet për Drejtorë, ku përfshihet pozicioni i Kryesekretarit (pra Drejtori i Administrimit Gjyqësor), Drejtori i Burimeve Njerëzore, Drejtori i IT-së dhe Sigurisë dhe Drejtori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë, si dhe gjithashtu të shpallen 2 (dy) vende për Sekretarë gjyqësorë, 1 (një) vend për Redaktor në Qendrën e Dokumentacionit dhe 1 (një) vend për Specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Financiare.